

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata supreme e Kosovës-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Nebojsha Boriqiq, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarve U.L. dhe M.K.i, për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë në bashkëkryerje nga neni 334 par.1 lidhur me par.2 dhe nenin 23 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit M.K., kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prizren P.nr.317/2014 datë 19.12.2016, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.867/2017 datë 12.09.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 16 janar 2018, morri këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit M.K., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prizren P.nr.317/2014 datë 19.12.2016, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.bnr.867/2017 datë 12.09.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prizren P.nr.317/2014 datë 19.12.2016, të dënuarit U.L. dhe M.K. janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale në bashkëkryerje legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 par.1 lidhur me par.2 dhe nenin 23 të KPK, dhe u janë shqiptuar secilit veç e veç dënimi me kusht ashtu që gjykata ju ka përcaktuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nga 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 2 (dy) vitesh nuk kryejnë vepër tjetër penale. Janë detyruar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë secili veç e veç, shumën prej nga 100 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Palët e dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin PA1.nr.867/2017 datë 12.09.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit M.K., ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit M.K., P.P., avokat nga P., për shkak të shkeljeve nga neni 432 të KPPK, mirëpo nuk precizon bazat ligjore, duke propozuar që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza ose të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr.221/2017 datë 20.11.2017, ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën e ushtruar, mbrojtësi i të dënuarit edhe pse nuk ka specifikuar bazat ligjore të këtij mjeti juridik, nga përmbajtja e kërkesës rezulton se aktgjykimet kundërshtohen për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale ndërsa, në pjesën dërmuese i referohet gjendjes faktike.

Në kërkesë, mbrojtësi thekson se i dënuari fillimisht është akuzuar për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, ndërsa në fjalën përfundimtare, prokurori i çështjes ka ndryshuar plotësisht identitetin e akuzës ashtu që tani e ka akuzuar për veprën penale legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 të KPK, më pas thekson se dispozitivi është i pakuptueshëm meqë gjykata ka aprovuar ndryshimin e përshkrimit të veprës të dhënë nga prokurori i çështjes, kështu që gabimisht është shënuar edhe data e supozuar kur është kryer vepra penale ashtu në vend të datës 11.11.2011, në dispozitiv është shënuar data 24.12.2010, që lidhet me datën e legalizimit të kontratës në gjykatë.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson si të pabazuara pretendimet e lartcekura nga këto arsye.

Siç rezulton nga shkresat e çështjes dhe aktgjykimet e kundërshtuara, në këtë çështje penale nuk kanë qenë kontestuese këto fakte: se vëllezër-të dëmtuarit D. dhe Xh.E., kanë blerë parcelat në vendin quajtur "Pusnica" sipas listës poseduese 145 parcela nr.7341 dhe 7342, dhe fletës poseduese 1197, nga tani i ndjeri S.Gj. me 21 mars 1974 sipas kontratës mbi shitblerjen e patundshmërisë, (kontrata nuk është

vërtetuar në gjykatë). Që nga ajo kohë blerësit kanë qenë në posedim të pronës. Ndërkohë, një pjesë të patundshmërisë ia kanë shitur dëshmitarit R.K.. Nuk është kontestues fakti se shitësi i kësaj patundshmërie S.Gj. ka vdekur me 25.04.1991, në Krushevcë-Serbi, gjë që vërtetohet nga ekstrakti i librit të amzës së të vdekurve datë 08.05.1991. Po ashtu, as fakti se O.M., me një person të komunitetit serb së bashku me të dënuarin M., në Gjykatën Komunale në Prizren, para se të lidhët kontrata i kanë prezantuar zyrtarit të gjykatës, një autorizimi të lëshuar nga autoritetet në Serbi me ç' rast janë informuar se autorizimi në fjalë nuk është valid-nuk është i pranueshëm për gjykatën. Më pas O.M., shkon në Shkup tek noterja V.S., ku merr një autorizim gjeneral dhe sipas dokumentacionit të ofruar nga noterja-librit të regjistrimeve rezulton se O.M. e ka autorizuar S.Gj., për shitjen e patundshmërisë. Ndërkohë, ky autorizim sipas dëshmitares V.S. është falsifikuar ashtu që në autorizimin gjeneral i cili është përdorur për vërtetimin e kontratës në gjykatë, janë ndryshuar rolet e palëve kështu që sipas autorizimit të falsifikuar S.Gj. figuron si autorizim dhënës, kurse O.M. autorizohet që t'i shes parcelat kadastrale 7331 në sipërfaqe prej 1220 m², parcelën 7341 në sipërfaqe prej 3008m² parcelën 7347-5 në sipërfaqe prej 400m² sipas listës poseduese UL-71813068-00118. Parcela nr.7341 sipërfaqe prej 3008m² sipas kontratës mbi shitblerjen e lidhur në mes të tani të ndjerit G. dhe vëllezërve D. dhe Xh.E., në vitin 1974 ka qenë pjesë e shitblerjes sipas kontratës së lidhur në mes dënuarit M. dhe O.M. Nuk ka qenë kontestues fakti siç ka pohuar edhe dëshmitarja-noterja V.S., se me rastin e identifikimit të personit Gj.S., ai nuk ishte prezent (sepse paraprakisht ai kishte vdekur në vitin 1991) ndërsa identiteti i tij është vërtetuar në bazë të dy dëshmitarëve dhe atë U.A.i dhe I.M.. Në shqyrtimin gjyqësor i dënuari U.L., ka pohuar se në vitin 2010 ka jetuar në Shkup dhe se e njeh personin I.M. dhe po ashtu ka pohuar se ka qenë në zyrën e noteres në fjalë në Shkup, por për çështje tjera, jo për autorizim dhe ka pohuar se O.M. e ka vëlla. Nga kjo del se personi i cili ka dëshmuar për identitetin e Gj.S. ishte i njëjti person, pra i dënuari U.L. dhe ka ditur për manipulimet rreth autorizimit.

Në bazë të këtij autorizimi, O.M. përpilon kontratën për shitblerjen e patundshmërisë (e cila akoma evidentohet në libra kadastral në emër të tani të ndjerit Gj.), me datën 22.12.2010, dhe ky si shitës i patundshmërisë sipas kontratës, ua shet U.L. (vëllait) dhe fqinjës së tij M.K.. Kjo kontratë vërtetohet në Gjykatën Komunale në Prizren Leg.nr.10825/2010 datë 24.12.2010. Si rezultat i kësaj të dënuarit M. dhe U., pajisen me certifikatën mbi të drejtën e pronësisë secili në ½ nr.UL.718-13068-00118 datë 11.11.2011.

Me të kuptuar për këtë, të dëmtuarit D.E., F.E. (i biri i Xh.E.) dhe R.K., denoncojnë rastin në polici, ndërsa në ndërkohë pasi që informohen nga të dëmtuarit, inkuadrohet edhe i biri i tani të ndjerit Gj., I.S., dhe trashëgimtar të tjerë, të cilët me deklaratimet e tyre kanë pohuar se patundshmëria në fjalë-parcelat kontestuese nga babai i tije tani i ndjerë Gj. janë shitur vëllezërve D. e Xh.E. me 21.03.1974. I dënuari M.

nuk e ka pranuar veprën penale, mirëpo ka theksuar se është manipuluar nga O. të cilit i ka besuar sepse është vëllai i U., ka pohuar se pagesën e ka kryer pasi kanë bërë bartjen e pronës në emër të tij dhe të U.. Më pas së bashku me gjeometrin kanë dalë në vendin e ngjarjes për të përcaktuar kufijtë, mirëpo paraprakisht ka kuptuar se atë pronë posedon dikush tjetër, ndërsa me të dalë në vendin e ngjarjes është bindur se parcelat nuk ishin ato të cilat i ka blerë por bëhet fjalë për një parcelë ku ishin të ndërtuara shumë shtëpi. Ka theksuar se 12 ari e kishte shitur por pjesa tjetër ka ngelur në të njëjtën gjendje.

Nuk është i bazuar pretendimi se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i pa qartë dhe kundërthënës. Qëndron fakti se në dispozitën të aktgjykimit janë specifikuar dy datat. Kështu data 24.12.2010, është data kur organi kompetent-Gjykata Komunale në Prizren është vu në lajthim me faktin se e ka vërtetuar kontratën me përmbajtje të pavërtetë (data e kryerjes së veprës penale), kurse data tjetër 11.11.2011, është data e regjistrimit të drejtës së pronësisë në zyrën kadastrale-komunale në Prizren, në dokumentin e lëshuar UL-71813068-00118, prandaj dispozitivi nuk është kundërthënës dhe i paqartë në kuptim të pretendimeve nga kërkesa.

Nuk është tejkaluar aktakuza siç pa bazë pretendohet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, për faktin se në këtë çështje penale, në shqyrtimin gjyqësor, pas administrimit të provave të propozuara, gjendja faktike ka ndryshuar për çfarë Prokurori i Shtetit ka ndryshuar përkrahimin faktik dhe cilësimin juridik të veprës penale nga aktakuza.

Nga shkresat e çështjes-procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 17.11.2016, rezulton se pas fjalës së prokurorit të çështjes lidhur me ndryshimin e aktakuzës në pyetjen e gjykatës nëse palët kërkojnë kohë shtesë për përgatitjen e mbrojtjes, i dënuari U.L. ka kërkuar që të shtyhet seanca e shqyrtimit gjyqësor me qëllim të përgatitjes së mbrojtjes, ashtu që seanca e radhës është caktuar për datën 06.12.2016. Në një situatë të këtillë, gjykata e shkallës së parë ka vepruar në harmoni me dispozitën e nenit 350 par.3 të KPPK.

Pjesa tjetër e kërkesës, i referohet gjendjes së fakteve meqë theksohet se veprimet e të dënuarit në asnjë mënyrë nuk mund të ndërlidhen me vërtetimin e autorizimit apo ndonjë dokumenti tjetër meqë kontrata e përpiluar është dokument legal e cila edhe tani është në fuqi. Theksohet se në këtë çështje vetëm O.M. mund të ketë përgjegjësinë penale ndaj të cilit edhe është paraqitur kallëzimi penal e jo edhe i dënuari M..

Bazuar në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, rezulton se përfundimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë lidhur me fajësinë e të dënuarit M., dhe cilësimin juridik të veprës penale, janë të drejta dhe të

ligjshme meqë veprimet konkrete inkriminuese i dënuari ka ndërmarrë me dashje direkte meqë që nga fillimi ka ditur se O.M., të cilën e ka njohur mirë, autorizimin e ka marrë në mënyrë të paligjshme. Po ashtu ka ditur se edhe para këtij rasti së bashku me O.M., kanë paraqitur një autorizim të lëshuar nga autoritetet serbe, gjykatës në Prizren, dhe pasi nga zyrtari i gjykatës janë informuar se autorizimi nuk është valid, O. ka bërë një autorizim tjetër në Shkup, ashtu që O. kinse autorizohet nga Gj.S. i cili kishte vdekur në vitin 1991, tregon fare mirë se i dënuari me çdo kusht ka dashtë ta përfundoj veprën gjë që edhe e ka realizuar me lidhjen e kontratës me përmbajtje të pa vërtet, të cilën më pas e ka vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren, duke ditur se objekt i kontratës ishte pasuria e huaj. Prandaj, sado që i dënuari tenton ta bind gjykatën se është manipuluar nga O.M., mbrojtja e tij është demantuar me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, prandaj drejt është aplikuar ligji penal.

Nga arsyet e lartcekura, kjo gjykatë refuzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
PML.nr.324/2017, datë 16 janar 2018

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta